



Nr. 215 Prot

Datë 13. 05. 2025

Nr. 58 Prot

Datë 13. 05. 2025

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

UNIVERSITETIT “WESTERN BALKANS”

DHE
QENDRËS KOMBËTARE TERAPEUTIKE DHE
REHABILITUESE PËR FËMIJËT

TIRANË, 2025





STERN BALKANS UNIVERSITY



ët më datë 13/05/2025, në Tiranë lidhet kjo marrëveshje bashkëpunimi midis palëve mëposhtme:

Jniversiteti “Western Balkans” (WBU) themeluar me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 579, datë 10.11.2021, “Për hapjen e institucionit të arsimit të lartë, jopublik, është person juridik themeluar nga Shoqëria “Western Balkans University” sh.p.k., i njohur nga legjislacioni civil dhe tregtar shqiptar, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NIPT M0231301F, autostrada Tiranë-Durrës, Km. 7, Kashar/Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar për këtë kontratë nga z. Ferdinand Gjana, President i “Western Balkans University” sh.p.k, *referuar në vijim si WBU*,

dhe

Qendrës Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët (QKTRF) e cila vepron në bazë të Kushtetutës, legjislacionit shqiptar në fuqi, në veçanti në bazë të Ligjit Nr.10 138, datë 11.5.2009, “*Për Shëndetin Publik*”, Ligjt Nr.7961 datë 12.07.1995 “*Kodi i Punës*” i ndryshuar, Ligjt Nr.18/2017 “*Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës*” dhe Ligjt 20/2021 Për disa shthesa dhe ndryshime në Ligjin NR. 44/2012 “*Për Shëndetin Mendor*”.

Qendra Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët në përpunje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë ka si mision:

- Trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues të personave me çrregullime të shëndetit mendor, në funksion të respektimit të integritetit fizik dhe dinjitetit njerëzorë.
- Ofrimin e kujdesit shëndetësor për personat me çrregullim të shëndetit mendor në një mjeshtësi sa më pak shtrëngues duke tentuar drejt nivelit komunitar për të minimizuar në maksimum zhvendosjet nga mjeshtësi familjar dhe për të lehtësuar integrimin dhe rehabilitimin social.
- Krijimin e lehtësirave për këtë kategori të vecantë personash dhe njëkohësisht edhe për familjarët e tyre me qëllim përfshirjen e tyre në jetën socialo-shoqërore.
- Vlerësimin dhe ofrimin e kujdesit për këta persona referuar modelit bio-psiko-social nga ekipe multidisiplinore që i përgjigjën në mënyrë komplekse nevojave mjeksësore, psikologjike, sociale dhe rehabilituese.
- Përmirësimin e cilësisë së jetesës së fëmijëve me nevoja të veçanta dhe ofrimin e mbështetjes familjareve të tyre në procesin e rehabilitimit, kujdesit *dhe edukimit* të fëmijëve.





Ushtimin e të drejtave të personave me çrregullime të shëndetit mendor në përputhje me Aktet Ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

EQËNËSE

A. Universiteti "Western Balkans" është një institucion i ri i Arsimit të Lartë i cili synon zgjerimin e bashkëpunimeve me institucione dhe qendra shëndetësore/reabilituese për fëmijë dhe të rritur, ai synon gjithashtu të ketë një ndikim transformues në shoqëri përmes inovacionit të vazhdueshëm në arsimin e lartë, kërkimit shkencor, kreativitetit dhe sipërmarrjes. Misioni i Universitetit "Western Balkans" është krijimi i një përvoje arsimore transformuese për të gjithë studentët, duke i drejtuar ata drejt njozhurive të thella disiplinore, të menduarit kritik, zgjidhjes së problematikave të ndyshme që kanë të bëjnë me shoqerinë ku jetojmë, aftësimi i studentëve në aspektet e drejimit, komunikimit, marrëdhënieve ndërpersonale, shëndetit dhe mirëqenies së tyre.

B. Ekziston një vullnet i lirë i palëve që të bashkëpunojnë në arritjen e qëllimeve të perbashkëta për:

- ✓ Bashkëpunimin me synim promovimin dhe mbështetjen e kërkimit shkencor, zhvillimin profesional dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta në fushën e fizioterapisë.
- ✓ Bashkëpunimin në fushën e iniciativave të përbashkëta për projekte, seminare, aktivitete vullnetare, workshopë etj për studentët dhe stafin akademik të WBU-së.
- ✓ Bashkëpunimin në fushën e asistencave teknike dhe profesionale reciproke të palëve.
- ✓ Shkëmbimin e eksperiençave më qëllim sensibilizimin dhe angazhimin e studentëve të fizioterapisë të Universitetit "Western Balkans"

Ky bashkëpunim do të kontribuojë në ngritjen e standardeve të arsimit dhe kujdesit shëndetësor në Shqipëri, duke u bërë një shembull i suksesit të partneriteteve strategjike.

Palët bien dakord si vijnë:





NENI 1 OBJEKTIVI

Palët me anë të kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi, duke vepruar mbi bazën e dispozitave të saj si dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi, do të përpilen të përforcojnë, promovojnë dhe zhvillojnë bashkëpunimin e tyre reciprok mbi bazën e barazisë dhe përfitimit të përbashkët në çdo fushë të kësaj marrëveshjeje.

NENI 2 FUSHAT E BASHKËPUNIMIT

1. “Qendra Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët” do të angazhojë studentë të Universitetit “Western Balkans” në praktika profesionale dhe internshipe.
2. “Qendra Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët” në kuadër të veprimtarisë së vet, do t’ju mundësojë studentëve të Universitetit “Western Balkans”, angazhimin në aktivitetet e ndryshme të saj.
3. “Qendra Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët” sipas kapaciteteve dhe nevojave të parashtruara nga anëtarët e vet, nëse ekziston gatishmëria dhe dëshira e mirë e personave në fjalë, do t’u mundësojë studentëve të Universitetit “Western Balkans” të jenë pjesë e bashkëpunimit dhe do të promovojë pjesëmarrjen e anëtarëve në aktivitete.
4. Ekspertë të “Qendrës Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët,” do të kenë mundësinë të mbajnë në Universitetin “Western Balkans” leksione, seminare dhe workshopë të tematikave të ndryshme, që kanë të bëjnë me zhvillimin profesional në fushën e Fizioterapisë gjatë të cilave mund të bëjnë promovimin e institucionit të tyre dhe të veprimtarisë së tij.
5. Palët do të realizojnë veprimtari të përbashkëta informuese, promovuese me qëllim zgjidhjen e problematikave, rritjen e imazhit të institucioneve respektive.
6. Palët do të zhvillojnë workshopë, seminare, aktivitete të ndryshme dhe shumë veprimtari të tjera të këtij lloji me interes reciprok.
7. Palët do të zhvillojnë veprimtari të përbashkëta promovuese me qëllim arritjen e objektivave të përbashkëta.
8. Logot e institacioneve pjesë e kësaj marrëveshjeje mund të përdoren dhe të vendosen në faqet zyrtare të institucioneve përkatëse.





NENI 3 KUSHTET E BASHKËPUNIMIT

1. Kjo marrëveshje bashkëpunimi nuk shoqërohet me detyrime apo impakt financiar ndërmjet palëve përvèc rasteve kur palët bien dakort ndryshe.
2. Kostot dhe shpenzimet që lindin nga kjo marrëveshje do të mbulohen nga secila palë me buxhetin e tyre.
3. Nëse nga bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve bazuar në parimet e mësipërme, lind nevoja për financimin e projekteve të përbashkëta, të dy institucionet do t'i rregullojnë këto raporte me anë të marrëveshjes së vecantë financiare, të cilat do të janë pjese integrale e kësaj Marrëveshjeje.
4. Të dy palët, në bazë të mundësive, mjeteve financiare që disponojnë dhe potencialit akademik e profesional, do të aplikojnë në organizma dhe institacione të ndryshme për realizimin e projekteve të përbashkëta.
5. Rezultatet e këtij bashkëpunimi dhe përfitimet reciproke kur ato ekzistojnë bëhen publike vetëm me aprovimin e të dy palëve. Palët ruajnë konfidentialitetin e informacioneve të perfituara nga njëri-tjetri.
6. Palët dakortësohen që të ruajnë dhe të respektojnë integritetin reciprok.

NENI 4 EFEKTET E KËSAJ MARRËVESHJE

Kjo marrëveshje bashkëpunimi nuk përbën ose krijon dhe nuk ka për qëllim të përbëjë ose të krijojë detyrime ligjore detyruese ose të zbatueshme, të shprehura ose të nënkuptuara.

NENI 5 PERSONAT E KONTAKTIT

Për të zbatuar objektivat e shprehura më sipër palët mirëkuptohen dhe bien dakort në mënyrë reciproke për sa më poshtë:

1. Propozimet për bashkëpunim sipas kësaj marrëveshjeje do të paraqiten përmes personave të kontaktit të caktuar nga secili institucion.
2. Për Universitetin "Western Balkans" person kontakti është Imena Ismaili, telefoni 0699288070, email imena.ismaili@wbu.edu.al





WESTERN BALKANS UNIVERSITY



3. Për "Qendrën Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët" person kontakti
është Ardi Qordja, nr. Telefon: 0682041721, email: Ardi.Qordja@qktrf.gov.al

NENI 6


HYRJA NE FUQI DHE KOHËZGJATJA

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit mes palëve dhe është e vlefshme për një periudhë 2-vjecare me të drejtë rikonfirmimi pas konfirmimit nga palët. Efektet e saj nisin nga data e nënshkrimit të marrëveshjes.

Secila palë mund të përfundojë marrëveshjen me anë të një njoftimi 1 (një) muaj përpara me shkrim.

Kjo kontratë rregullohet, interpretohet dhe zbatohet në përporthje me legjisacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Ajo mund të ndryshohet në cdo moment nëse palët bien dakord dhe vetëm me anë të një dokumenti të shkuar dhe të nënshkuar nga përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

UNIVERSITETI "WESTERN
BALKANS"



Prof. Dr. Ferdinand GJANA
President

"QENDRA KOMBËTARE
TERAPEUTIKE DHE
REHABILITUESE PËR FËMIJËT"

Dr. Florida DOBI
Drejtor

